

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6682
E enjte, 18 gusht 2022
çmimi 0.40 €

Grenelli: Marrëveshja
e Uashingtonit u negocia
e gjitha nga Thaçi | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TË MËRKURËN KURTI DHE VUÇIQI JANË TAKUANRME SHEFIN E NATO-S, SOT
(E ENJTE) TAKOHEN ME ZYRTARËT E BE-SË PËR DIALOGUN | FAQE 4-5

NATO, SERBISË: KFOR-i I GATSHËM TË INTERVENOJË NËSE CENOHEH SIGURIA E KOSOVËS



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen sot (e enjte) në Bruksel në kuadër të dialogut. Ky takim vjen pas tensioneve në veri të Kosovës më 31 korrik. Një ditë para takimit, në selinë e NATO-s në Bruksel, shefi i kësaj organizate, Jens Stoltenberg, i ka pritur ndaras Kurtin dhe Vuçiqin. Pas

takimeve, Stoltenbergu ka thënë se i takon Prishtinës dhe Beogradit ta shmangun përshkallëzimin e situatës. Po ashtu, ai ia ka bërë të qartë Serbisë se KFOR-i në Kosovë është i gatshëm të intervenojë nëse cenohet siguria. Ndërsa kryeministri Kurti ka kërkuar anëtarësimin e Kosovës në NATO

OPINION

A I ËSHTË RIKTHYER
AMBASADORIT HILL DËSHIRA
PËR KOSOVËN ME AUTONOMI
SUBSTANCIALE? | F. 3

Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE



OPOZITA KËRKON SHKARKIMIN E
AMBASADORIT MARTIN BERISHAJ | F. 7

PROCEOHEH PËR KONSULTIME
PROJEKTLIGJI I PAGAVE
DHE AI PËR ZYRTARËT PUBLIKË | F. 7

KASTRATI MERRET NË PYETJE
NGA AUTORITETET SERBE, PYETJE
PËR LIMAJN DHE LARGIMIN E TIJ
NGA LV-ja | F. 3

EKONOMI



SHTATË PERSONA HUMBËN JETËN
NË VENDIN E PUNËS GJATË KËTIJ
VITI NË KOSOVË | F. 8

SHATRI PËR SITUATËN EKONOMIKE:
QEVERIA KURTI PO VEPRON SIKUR
TË ISHTE ARMIKE E QYTETARËVE | F. 8

SHQIPËRI -
KOSOVË DREJT
TRAKTATIT PËR
MBROJTJE TË
NDËRSJELLË? | FAQE 5



HOXHAI: KOSOVA PO
UDHËHIQET NGA FRIKA | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Të pasurit do të paguajnë më shumë taksa në ShBA, Bideni nënshkruan vendimin

WASHINGTON, 17 GUSHT - Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka nënshkruar një projektligj prej 700 miliardë dollarësh, që synon t'i luftojë ndryshimet klimatike dhe kostot e kujdesit shëndetësor duke rritur taksat kryesisht për të pasurit.

Projektligji përfshin masat për ta ulur çmimin e barnave me recetë. Sipas një zyrtari të administratës së Bidenit, projektligji mund të japë një shtysë përpara zgjedhjeve afatmesme.

Votuesit që do të votojnë në nëntor do të vendosin nëse demokratët e Bidenit do ta mbajnë kontrollin e Kongresit edhe për dy vjet të tjera. Presidenti e përshëndeti

projektligjin, ndërsa e nënshkroi të martën si "pjesa e fundit" e agjendës së tij të brendshme, shkruan "BBC".

Projektligji, i quajtur "Akti i reduktimit të inflacionit", është një arritje e madhe legislative për demokratët ku përfshihet paketa më e madhe klimatike në historinë e ShBA-së dhe bëhet menjëherë një nga elementët kyç të presidencës së tij dyvjeçare. Ajo ka kaluar në votim në Dhomën e Përfaqësuesve dhe në Senatin javën e kaluar me mbështetjen e çdo demokrati, por të asnjë republikani.

Në këtë paketë përfshihen masa të dizajnuara për t'i mbështetur

alternativat e energjisë me emetim të ulët dhe për t'u ulur emetimet e gazrave serrë, si dhe për t'i ulur çmimet e barnave me recetë dhe për t'i rritur taksat ndaj korporatave dhe të pasurve. Legjislacioni do të mbledhë rreth 700 miliardë dollarë nëpërmjet rritjes së taksave të korporatave dhe kursimeve të barnave me recetë dhe do të shpenzojë rreth 400 miliardë dollarë për energjinë e pastër dhe dispozitat e kujdesit shëndetësor. Bideni është kthyer nga pushimet për ta nënshkruar projektligjin, i cili është miratuar sipas linjave partiake, pa asnjë mbështetje nga republikanët e opozitës.



Gjermania do të sigurojë gaz nga Norvegjia

OSLO, 17 GUSHT - Gjermania dhe Norvegjia do ta zgjerojnë bashkëpunimin në sektorin energjetik.

Kryeministri norvegjez, Jonas Gahr Store, ka thënë se nuk shikon aktualisht mundësi për të transportuar më shumë gaz drejt Gjermanisë dhe Evropës. Norvegjia e ka rritur prodhimin e gazit pas sulmit rus në Ukrainë gati me 10 për qind, ka theksuar kryeministri norvegjez pas një takimi me kancelarin gjerman Olaf Scholz në Oslo.

Aktualisht po "furnizojmë maksimalisht sa mundemi", ka thënë ai, duke shtuar se nuk vendos qeveria nëse prodhimi i gazit mund të zgjerohet. "Ne nuk mund të vendosim politikisht, se tani do të furnizojmë më shumë", ka thënë ai.

"Ky është vendim i sipërmarrjeve. Për një prodhim më të madh në Norvegji, duhet që të vihen në punë rezerva të tjera të gazit", thuhet. Me këtë shtet, pas Katarit, bie shpresa e Gjermanisë se mund ta

zëvendësojë shumë shpejt gazin rus. Ndërsa kancelari gjerman, Olaf Scholz, ka falënderuar Norvegjinë që "po shfrytëzon deri në limit" rezervat e gazit. Kjo, sipas tij, është "shumë e rëndësishme, që ta zvogëlojmë varësinë nga gazi rus".

Rëndësi ka premtimi i Oslos, që ta ruajë nivelin e lartë të prodhimit, sepse edhe në vitin 2023 do të ketë nevojë të mëdha për gaz. Jo vetëm ky dimër është një sfidë e madhe për Gjermaninë. Edhe në vitin e ardhshëm duhet të mbushen depozitat e gazit. "Partneritetin tonë energjetik ne duam ta zgjerojmë dhe thellojmë", ka thënë kancelari Scholz.

Takimi i Këshillit Ministerial të Veriut

Kancelari gjerman ka marrë pjesë në Oslo në takimin e Këshillit Ministerial të Veriut ku, krahas Scholz dhe Store, kanë marrë pjesë kryeministri i



Suedisë, i Danimarkës, i Finlandës dhe i Islandës. Temat kryesore ishin furnizimi me energji dhe gjendja e sigurisë. Si kurrë më parë, Norvegjia ofron gaz për Evropën dhe Gjermaninë. Furnizimet nga Norvegjia që nga fillimi i luftës

në Ukrainë janë rritur ndjeshëm. Në Gjermani pjesa e gazit norvegjez përbën tani 30 për qind të furnizimit, duke e kaluar kështu Rusinë. Nga Rusia aktualisht përmes "Nord Stream 1" vijnë rreth 20 për qind të sasisë së premtuar, kurse BE-ja

importon rreth 20 për qind të gazit nga Norvegjia.

Pas sulmit rus kundër Ukrainës, Ministria e Energjetikës në Oslo ka modifikuar licencat e nxjerrjes së gazit për fusha të gazit në mënyrë që të përfitohej më shumë gaz, por prodhimi dhe kapacitetet e gazsjellësve janë në përdorim maksimal. Për Norvegjinë tani bëhet fjalë që të shfrytëzojë burime të reja për ta rritur eksportin, ka thënë Store pas takimit me kancelarin gjerman. Ky vend do ta furnizojë Gjermaninë edhe më tej me gaz të lëngshëm. Vendet nordike dhe Gjermania do të bashkëpunojnë më ngushtë në të ardhmen në fushën energjetike.

Kryeministri norvegjez, Jonas Gahr Store, e ka lëvduar Gjermaninë. Gjermania "i hyri sfidës së madhe të përftojë energji të rigjenerueshme". "Por largimi nga energjitë fosile nuk do të jetë i lehtë dhe pa turbulenca", ka thënë Storen. /DW/

Thatësira i detyron kompanitë kineze të mbyllën

PEKIN, 17 GUSHT - Fabrikat në rajonin jugperëndimor të Kinës janë mbyllur pasi rezervuarët e përdorur për të prodhuar energji nga hidrocentralet kanë rënë në nivele të ulëta për shkak të thatësisë.

Kompanitë në provincën Siçuan, përfshirë prodhuesit e paneleve diellore dhe çimentos, u mbyllën ose shkurtuan prodhimin, pasi u urdhëruan që ta kursenin energjinë për pesë ditë, raportuan mediet. Arsyeja është kjo: nivelet në rezervuarë ranë në nivele të ulëta dhe u rrit kërkesa për përdorimin e energjisë për ajër të kondicionuar për shkak të temperaturave të larta.

Autoritetet provinciale i kanë urdhëruar kompanitë ta kursenin energjinë në mënyrë që qytetarët



të mund ta shfrytëzojnë atë.

Këto mbyllje të fabrikave rrisin presionin ndaj Partisë Komuniste dhe presidentit Xi Jinping, i cili po kërkon ta fitojë mandatin e tretë pesëvjeçar në takimin e partisë që do të mbahet në tetor ose nëntor. Rritja e prodhimit të fabrikave dhe shitja me pakicë ranë në

muajin korrik, pasi Shangai dhe qendrat e tjera industriale u mbyllën që nga fundi i marsit për shkak të shpërthimeve të reja të pandemisë së koronavirusit. Ekonomia e Kinës është rritur vetëm për 2.5 për qind krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, apo më pak se gjysma e

objektivit zyrtar të rritjes ekonomike prej 5.5-përqindësh. Zonat në Kinën qendrore dhe veriore kanë ndërmarrë masa për t'u siguruar që të ketë furnizime me ujë të pijshëm, pasi shteti është përballur me reshje më të pakta sesa zakonisht. Agjencia zyrtare e lajmeve, "Xinhua", ka raportuar se autoritetet kanë dërguar ujë me kamionë në dy fshatrat pranë Çongqing, që janë goditur rëndë nga thatësira.

Qindra-mijëra hektarë të mbjella me produkte bujqësore në mbarë Kinën qendrore dhe veriore janë tharë për shkak të mungesës së ujit dhe temperaturave të larta, ka njoftuar qeveria kineze. Agjencia e motit në Kinë ka paralajmëruar se disa zona të vendit do të përballen me

temperatura deri në 40 gradë celsius. Në Siçuan, ku jetojnë 94 milionë banorë, nivelet e ujit në rezervuarët e hidrocentraleve ranë në nivele të ulëta gjatë këtij muaji, thanë autoritetet. Në këtë rajon operojnë kompani që prodhojnë panele diellore sikurse "Tongwei Solar Co. Ltd" dhe "GCL-Poly Energy Holdings Ltd", të cilat kanë thënë se kanë marrë njoftim nga autoritetet që të kursejnë energjinë. Kina ishte përballur me situatë të ngjashme vitin e kaluar në provincën Guangdong, që është një prej qendrave më të rëndësishme në botë të prodhimit. Autoritetet kishin urdhëruar fabrikat në këtë provincë në juglindje që të mbylleshin për shkak të niveleve të ulëta të ujit në rezervuarë.

Hoxhaj: Kosova po udhëhiqet nga frika

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Nën kryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se Kosova po udhëhiqet nga frika, duke shtuar se politika e jashtme po udhëhiqet nga slogani në slogan. Hoxhaj në "Facebook" ka shkruar për një deklaratë të qeverisë të bërë në janar të vitit 2022, për një marrëveshje ku Kosova dhe Serbia të zotohen për mossulm ndaj njëra-tjetres. Në këtë kontekst, Hoxhaj ka përmendur deklaratën e presidentes Vjosa Osmani në takim me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, e cila ka thënë se duhet të bëhet një traktat i mbrojtjes së ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. "As edhe në ëndrën më të keqe nuk e kam paramenduar që politika e jashtme të lëkundet nga slogani në slogan, pa qëllime dhe pa strategji! Një slogan nga qeveria e dëgjua në muajin janar të 2022-s, për një marrëveshjeje ku Kosova dhe Serbia zotoheshin të mos e sulmojnë njëra-tjetrën! Një slogan të ri e dëgjua dje nga presidentja

e Kosovës për një traktat të mbrojtjes së ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë!", ka shkruar ai. Më tutje, Hoxhaj ka thënë se konceptualisht marrëveshja për mossulm dhe e traktatit të mbrojtjes reciproke i takojnë kohës në mes të dy luftërave botërore. "Konceptualisht, marrëveshja për mossulm dhe e traktatit të mbrojtjes reciproke i takojnë kohës në mes të dy luftërave botërore! Në një kohë të sotme, kur edhe Suedia dhe Finlanda po anëtarësohen në NATO, duke kërkuar mbrojtje kolektive nga ajo! Ideja e traktatit të mbrojtjes është serioze vetëm nëse do të ishte diskutuar dhe koordinuar paraprakisht me Shqipërinë! Të mos shpallet vetëm si slogan, duke pasur në krah, pa paralajmërim, presidentin e Shqipërisë, që u zu në befasi dhe nuk tha asgjë në konferencën për medie!", ka shkruar Hoxhaj. Ai ka thënë se Kosova ka një partneritet strategjik me



Shqipërinë nga janari i 2014, i dalë nga mbledhje të qeverisë të përbashkëta, marrëveshje të nënshkruara me sekretariat që koordinon tema dhe ku prioritet i lartë është fusha e sigurisë. "Sigurisht që ky mekanizëm do të merrej me temën dhe përmbajtjen e traktatit para se të miratohej në Kuvend. Duket se nuk e dinë këtë. Por, të paktën, besoj që e dinë se Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe që një traktat i tillë nuk ndodh

pa koordinim me të. Jam për bashkëpunim me Shqipërinë si adresë kryesore e hartimit të partneritetit strategjik, por shqetësimi kryesor është paaftësia e tyre për t'i shfrytëzuar mundësitë pas rastit të Ukrainës, për t'u bërë të paktën pjesë e Partneritetit për Paqe të NATO-s!", ka shkruar Hoxhaj. Ish-kryediplomati i Kosovës ka thënë se agresioni rus duhet të përdoret për ta rritur kapacitetin

tonë ushtarak, për ta izoluar Serbinë në rajon dhe anëtarësuar Kosovën në NATO. "Është ajo që po e mbron Evropën dhe mbron shtetet. Kur kryeministri javën e kaluar foli për luftën dhe presidentja këtë javë për traktatin e mbrojtjes, qëllimisht po mbjellin një atmosferë frike, duke zëvendësuar temat e brendshme të krizës ekonomike dhe me slogane të politikës së jashtme!", ka shkruar Hoxhaj. Ai ka thënë se Kosova për shumë vite ka qenë e sigurt nga pikëpamja psikologjike, kurse në javët e fundit, siç është shprehur ai, Kosova po udhëhiqet nga frika. "Kjo nuk po bëhet për ta mbrojtur shtetin dhe sovranitetin, por për ta përmbushur egoizmin personal dhe populizmin partiak! Kjo është kohë që kërkon vendosmëri, maturi dhe qëndrueshmëri. Nuk është kohë e parullave si frymëzime të çastit drejt moçalit politik, nga ku s'mund të dalim asses! Tani, takimin e 18 gushtit, a do ta filloni nga mossulmi, apo nga mbrojtja?", ka shkruar Hoxhaj.

Kastrati merret në pyetje nga autoritetet serbe, pyetet për Limajn dhe largimin e tij nga LV-ja

Prishtinë, 17 gusht - Të shtunën e 13 gushtit, derisa po udhëtonte nga Prishtina drejt Vjenës, ish-kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, është marrë në pyetje nga autoritetet serbe në pikën kufitare "Dheu i Bardhë". Sipas deklaratës së tij, dy policë të uniformuar serbë e kanë shoqëruar te zyrat e tyre për t'u intervistuar nga një person i tretë. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka njoftuar se Kastrati pas një kohe është intervistuar nga dy persona të pauniformuar në gjuhën angleze për faktin se komunikimi në gjuhën serbe nuk ka mundur të bëhet sepse ai nuk e flet këtë gjuhë. Sipas deklaratës së tij, ai është pyetur kryesisht për aktivitetin e tij politik, për figurat politike të Gjilanit e të Kamenicës, për Fatmir Limajn dhe për arsyet e largimit nga Lëvizja Vetëvendosje. "Fillimisht i është



kërkuar ta ç'kyç telefonin në ndërkohë që Qëndron Kastrati, me një mesazh e kishte informuar KMDLNJ-në për ndalesën nga autoritetet serbe. Më tutje, në deklaratën e Qëndron Kastratit thuhet se ai është pyetur kryesisht për aktivitetin e tij politik, njohuritë me dhe për figurat politike të Gjilanit dhe të Kamenicës, nëse personalisht e njeh Fatmir Limajn, arsyet pse ishte larguar nga Lëvizja Vetëvendosje dhe nëse mendon që përsëri të kandidojë për kryetar të Kamenicës. Në insistimin e Qëndron Kastratit që t'i bëhet i ditur identiteti i intervistuesve, qëllimi i ndalimit dhe t'i sigurohet një mbrojtje ligjore përmes përfaqësuesit gjatë intervistimit, është liru për t'u kthyer në Kosovë, duke e pajisur me një dokument për hyrje-dalje, në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik,

të cilin nuk e ka kuptuar për shkak të mosnjohjes së gjuhës serbe. Në pyetjet e KMDLNJ-së nëse janë kërcënuar, nëse është përdorur forcë apo ndonjë kërcënim tjetër, të intervistuarit e mëparshëm si dhe Qëndron Kastrati kanë deklaruar se sjellja ka qenë korrekte dhe se kanë kërkuar informata, kryesisht të natyrës politike, për persona të caktuar dhe ngjarje të caktuara, ka njoftuar KMDLNJ-ja. Me këtë rast, KMDLNJ-ja ka dënuar ndalimin e Kastratit dhe intervistimin e shtetasve të Kosovës që për qëllim kanë kufizimin e lirisë së lëvizjes përmes presionit. "Ndalimi dhe intervistimi i qytetarëve të Kosovës nga autoritetet serbe po përdoret edhe për tensionim të situatës në kohën kur kjo situatë është e brishtë dhe me mundësi të përshkallëzimit", ka njoftuar KMDLNJ-ja.

Specialja publikon aktgjykimin prej 375-faqesh në gjuhën shqipe ndaj Gucatit dhe Haradinajt

HAGË, 17 GUSHT - Gjykata Speciale e Kosovës në Hagë ka publikuar në faqen zyrtare aktgjykimin prej 375-faqesh, në versionin e redaktuar, në gjuhën shqipe, të shpallur më 18 maj 2022 ndaj dy drejtuesve të OVLUÇK-së, Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt. Gucati dhe Haradinaj më 18 maj janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar me nga 4 vjet e gjysmë burgim dhe gjobë në shumën prej 100 eurosh për veprat penale që ndërlidhen me pengimin e administrimit të drejtësisë. Hysni Gucati së bashku me Nasim Haradinajn

akuzoheshin për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. "Akuzat e paraqitura në aktakuzën e konfirmuar mbështeten në dyshimin e bazuar mirë se, së paku, midis 7 dhe 25 shtatorit 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj zbuluan pa autorizim informacion të mbrojtur prej Ligjit të Dhomave të Specializuara, ndër të cilat të dhëna identifikuese të disa

dëshmitarëve (të mundshëm), në tri konferenca shtypi dhe aktivitete të tjera të transmetuara, si edhe përmes shpërndarjes së mëtejshme ku përfshihen deklaratat në rrjetet sociale", ishte thënë në njoftimin e Gjykatës Speciale. Po ashtu, Gucati dhe Haradinaj ngarkoheshin se kanë bërë komente nënçmuese kundër dëshmitarëve të mundshëm dhe në mënyrë të përsëritur shprehen synimin e tyre për ta dëmtuar punën e Dhomave të Specializuara. "Me këto veprime, z. Gucati dhe z. Haradinaj shkelën fshehtësinë e procedurës dhe frikësuan



dëshmitarë (të mundshëm) të Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe, si pasojë, penguan punën dhe hetimet e ZPS-së", ishte thënë në

njoftimin e Speciales. Të gjitha këto akuzë ishin mohuar nga Gucati dhe Haradinaj, por Gjykata Speciale kishte vendosur ndryshe.



TË MËRKURËN KURTI DHE VUÇIQI JANË TAKUANRME SHEFIN E NATO-S, SOT (E ENJTE) TAKOHEN ME ZYRTARËT E BE-SË PËR DIALOGUN

NATO, Serbisë: KFOR-i i gatshëm të intervenojë nëse cenohet siguria e Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, do të takohen sot (e enjte) në Bruksel në kuadër të dialogut. Ky takim vjen pas tensioneve në veri të Kosovës më 31 korrik. Një ditë para takimit, në selinë e NATO-s në Bruksel, shefi i kësaj organizate, Jens Stoltenberg, i ka pritur ndaras Kurtin dhe Vuçiqin. Pas takimeve, Stoltenbergu ka thënë se i takon Prishtinës dhe Beogradit ta shmangun përshkallëzimin e situatës. Po ashtu, ai ia ka bërë të qartë Serbisë se KFOR-i në Kosovë është i gatshëm të intervenojë nëse cenohet siguria. Ndërsa kryeministri Kurti ka kërkuar anëtarësimin e Kosovës në NATO

EPOKA E RE

Lirim GECI

BRUKSEL, 17 GUSHT - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, të mërkurën ka pritur në takime kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në këto takime është biseduar për situatën e tensionuar në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe për dialogun në mes të këtyre dy shteteve.

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, në një konferencë të përbashkët për medie me Vuçiqin, ka thënë se u takon Prishtinës dhe Beogradit ta shmangin përshkallëzimin e situatës. Stoltenbergu ka thënë se situata në terren është përmirësuar, ndonëse misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR-i, është duke e vëzhguar situatën dhe është i gatshëm të intervenojë në rast të destabilizimit të situatës.

I pyetur se çfarë nënkupton paralajmërimi për intervenim të NATO-s, Stoltenbergu ka thënë se KFOR-i është në kontakt të ngushtë me autoritetet në Beograd dhe Prishtinë. "Nëse ka nevojë, ne do t'i lëvizim forcat dhe do ta rrisim praninë tonë. Tashmë kemi rritur praninë në veri. Ne do të veprojmë kur ka nevojë dhe në mënyrë proporcionale", ka thënë ai në një konferencë për medie mbajtur pas takimit me Vuçiqin. Më tutje, ai ka thënë se fakti që KFOR-i është misioni më i madh ushtarak i NATO-s jashtë aleancës, flet për përkushtimin e saj në parandalim të

tensioneve.

Ndërsa presidenti i serb, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se Serbia respekton misionin e KFOR-it në Kosovë. "Kemi folur për atë që ka ndodhur. Nuk kemi nevojë që të shohim secilën herë situatën sipas një perspektive. E respektojmë misionin e KFOR-it dhe njoftimi i tij atë natë ka ndikuar në ulje të tensioneve", ka thënë Vuçiqi, duke iu referuar deklaratës së misionit të NATO-s më 31 korrik, se është i gatshëm të intervenojë nëse përshkallëzohet situata në veri të Kosovës.

Sa i përket dialogut me Kosovën, Vuçiqi takimin e sotëm me Kurtin e ka parë të vështirë. "Paqja dhe stabiliteti janë shumë të rëndësishme për Serbinë. Nuk dua t'ia lë fajin dikujt. Do të kemi diskutime të vështira nesër. Ne nuk pajtohemi thujse për asgjë. Ne duam ta forcojmë bashkëpunimin me KFOR-in dhe NATO-n dhe duam të evitojmë çfarëdo konflikti. Ne besojmë se nuk kemi bërë asnjë lloj provokimi", ka thënë Vuçiqi.

Sot takohen Kurti dhe Vuçiqi, ndërkombëtarët kërkojnë dialog konstruktiv

Kurti dhe Vuçiqi janë takuar me shefin e NATO-s një ditë para takimit në Bruksel në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi. Para këtij takimi, përfaqësuesit ndërkombëtarë kanë bërë thirrje për dialog konstruktiv. Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë ka thënë se takimi i

Brukselit është një mundësi e mirë për t'i ulur tensionet dhe për t'i normalizuar marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve. "I dërguari i posaçëm i Britanisë së Madhe për Ballkanin Perëndimor, Stuart Peach, foli të martën me kryeministrin e Kosovës dhe presidentin serb, duke nënvizuar shqetësimin e Britanisë së Madhe për rritjen e tensioneve dhe gjuhën e nxehtë të ditëve të fundit. Udhëheqësit tani kanë mundësinë dhe përgjegjësinë në bisedimet e tyre në Bruksel për të vënë qytetarët e tyre në radhë të parë, për t'i forcuar më tej arritjet e deritanishme në dialog dhe për të bërë hapa të rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve", ka njoftuar Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë.

Ndërsa shefja e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Caroline Ziadeh, u ka bërë thirrje të mërkurën Kosovës dhe Serbisë që të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. "Është tejet e rëndësishme që të promovohet një klimë e favorshme për dialog të mirëfilltë. Palët duhet të punojnë me mirëbesim për të adresuar çështjet e pazgjidhura, duke kapitalizuar angazhimin e 11 vjetëve të fundit dhe duke siguruar që të ndërtohet mbi të arriturat me mund në dialogun e lehtësuar nga BE-ja", ka thënë Ziadeh sipas një komunikate të lëshuar për medie.

Ndërsa ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, para takimit të kryeministrit Kurti me presidentin serb Vuçiq në Bruksel, ka thënë se e ardhmja e serbëve të Kosovës gjendet në tavolinën e bisedimeve. "Në lidhje me dialogun duhet thënë se problemet janë shumë të njohura dhe një problem themelor është të gjejmë, cila do të jetë e ardhmja e serbëve në Kosovë e të adresohen çështje se çfarë lloj fqinjësh duan të jenë ata në të ardhmen", ka thënë Hilli për "DW".

Ai ka thënë se ka gjithmonë rrezik që situata të shkallëzohet, prandaj ka theksuar se është detyra e gjithkujt të qetësohen tensionet. "Njerëzit mendojnë më mirë kur nuk kanë tensione

dhe kërkojnë më mirë rrugët për të ecur përpara kur nuk ka tensione", ka thënë ambasadori amerikan në Beograd.

Takimi i sotëm shënon herën e tretë që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, negociojnë në Bruksel. Kurti dhe Vuçiqi janë takuar dy herë vitin e kaluar, por pa ndonjë rezultat konkret. Ata janë ftuar në dialog pas tensioneve në veri të Kosovës më 31 korrik. Qeveria e Kosovës pati marrë vendim për zbatim të vendimit për targa dhe dokumentet serbe nga 1 gushti. Sipas vendimit të qeverisë, pronarët e makinave me targa të qyteteve të Kosovës - që lëshohen nga autoritetet serbe - duhet t'i reregjistrojnë ato në RKS. Po ashtu, të gjithë shtetasit serbë duhet të pajsisen me një dokument për

hyrje/dalje në pikëkalimet kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kosova dhe Serbia kanë marrëveshje për lëvizje të lirë prej vitit 2011. Serbia e ka zbatuar menjëherë këtë marrëveshje. Kosova e ka zbatuar për pak orë më 1 gusht, pasi e ka shtyrë zbatimin e vendimit për 1 shtator, me qëllim të uljes së tensioneve në veri. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar një shtyrje të tillë, ndonëse kanë thënë se Kosova ka të drejtë t'i zbatojë këto vendime. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011. Kosova insiston që dialogu për normalizim të marrëdhënieve të përmbyllet me njohje reciproke në mes të dyja vendeve. Serbia, në anën tjetër, është duke kërkuar zgjidhje kompromisi.

Kurti kërkon anëtarësimin e Kosovës në NATO

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, pas takimit me kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se KFOR-i është i gatshëm të intervenojë nëse do të rrezikohet sovraniteti i Kosovës. "KFOR-i është gati të intervenojë nëse sovraniteti është në rrezik. NATO vazhdon përkushtimin për sigurimin e stabilitetit të Kosovës", ka thënë Stoltenbergu në një konferencë të përbashkët me Kurtin. Ai e ka inkurajuar Kosovën dhe Serbinë që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin përmes dialogut që mbahet sot (e enjte).

Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka falënderuar NATO-n për angazhimin në Kosovë, derisa ka thënë se Kosova është e gatshme ta japë kontributin e saj brenda kësaj aleance me ushtrinë e saj, FSK-në. "Ne kërkojmë anëtarësimin në NATO. Anëtarësimi do të na mundësojë të japim atë që shtetet e tjera na kanë dhënë neve si qytetarë. Anëtarësimi në Partneritetin për Paqe do të

ishite një hap para", ka thënë Kurti.

Kurti ka shtuar se qytetarët e Kosovës kanë arsye të jenë vigjilentë këto ditë për shkak "të qasjes destruktive të fqinjës sonë veriore ndaj Kosovës dhe rajonit në përgjithësi". I pyetur nëse ka mundësi të zbrapsset nga hapi për ta zbatuar vendimin për targa dhe dokumentet serbe, Kurti ka thënë se implementimi përbën veprim legal. "Po zbatojmë diçka që është legale sipas ligjit dhe Kushtetutës sonë, për të cilën është zotuar edhe Serbia në dialogun e Brukselit. Nuk shohim rrugë tjetër dhe besoj se është në të mirën tonë t'i bëjmë legjitime gjërat në shtetin tonë", ka thënë ai.

Kurti është pyetur edhe nëse e pranon deklaratën se të dyja palët janë përgjegjëse për përshkallëzim të tensioneve. "Në njërin anën kemi policinë e shtetit demokratik të Kosovës, në anën tjetër kemi struktura ilegale serbe që janë kthyer në banda kriminale", ka deklaruar Kurti.



© Press Office, Presidency of Kosovo

Shqipëri - Kosovë drejt traktatit për mbrojtje të ndërsjellë?

PRISHTINË, 17 GUSHT - Presidentja Vjosa Osmani, pas takimit me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, ka kërkuar që Shqipëria e Kosova të kenë një traktat për mbrojtje të ndërsjellë me të cilin të reagojë në rast cenimi të të dy shteteve. Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, të martën ka përfunduar vizitën dyditore në Prishtinë, të parën që ai kryen jashtë vendit, pas marrjes së detyrës së shefit të shtetit muajin e kaluar. Bashkëpunimi dypalësh në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, dialogu Kosovë - Serbi, situata në Kosovë dhe rajon, marrëdhëniet dypalëshe ishin temat kryesore të bisedimeve që presidenti Begaj ka zhvilluar me autoritetet e Kosovës, kanë bërë me dije zyra për medie e Presidencës në Tiranë.

Traktat dypalësh në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas bisedimeve me presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj, citohet të ketë thënë që “në kushte kur po sfidohet arkitektura e sigurisë jo vetëm në kontinentin tonë,

por dhe më gjerë, siguria është shndërruar në prioritet, Kosova po koordinohet plotësisht me partnerët e saj strategjikë që rajoni të ndihet çdo ditë dhe më i sigurt”, raporton “DW”. Për presidenten Osmani “ka rëndësi që Shqipëria dhe Kosova të kenë një traktat për mbrojtje të ndërsjellë me të cilin do të reagojmë në rast të cenimit të dy shteteve tona”, ka theksuar ajo pas takimit me presidentin Begaj. Ajo e ka quajtur realizimin e një traktati të tillë “në harmoni me praktikatat ndërkombëtare, të aplikueshëm nga shumë shtete dhe aleatët tanë strategjikë”. Prandaj, sipas saj, është koha të bëhen hapat e duhur në këtë drejtim. Ndërsa presidenti Begaj ka deklaruar se “Kosova dhe Shqipëria kanë të njëjtin vizion për të njëjtën rrugë. Stabiliteti rajonal dhe paqja duhen mbajtur”.

BE-ja dhe tendencat destabilizuese të Serbisë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është cituar nga presidenca shqiptare të

ketë kritikuar BE-në lidhur me qëndrimin ndaj atyre që ajo i ka quajtur “tendenca destabilizuese të Serbisë”. “Presim që BE të jetë më i zëshëm përballë tendencave destabilizuese të Serbisë ndaj të gjithë rajonit. Tendencia të nxitura dhe që u shërbejnë interesave të Rusisë. Nuk ka dhe nuk mund të ketë ekuivalencë të trajtimit të palëve, kur qartazi Serbia është agresorja dhe ajo po përdor retorikë luftënxitëse në raport me Kosovën, por dhe veprime që po cenojnë paqen dhe stabilitetin e Kosovës”, citohet të ketë thënë presidentja Osmani në konferencën e përbashkët për medie me presidentin Begaj.

Ndërsa presidenti Begaj ka garantuar autoritetet e Prishtinës se Shqipëria mbështet anëtarësimin e Kosovës në NATO, në atë që quhet “aleanca garantuese e paqes në rajon”. Në takimin që Begaj ka zhvilluar me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajari, lidhur me situatën në veri të Kosovës, ai e ka quajtur “të pazëvendësueshëm rolin e KFOR-it në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në Kosovë dhe në gjithë rajonin.

Kancelari gjerman, inkurajues për rezultatin e dialogut Kosovë - Serbi

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, e ka quajtur inkurajues qëndrimin e kancelarit gjerman Olaf Scholz lidhur me rezultatin përfundimtar të dialogut Kosovë - Serbi. “Qëndrimi i ripërsëritur i kancelarit gjerman, Scholz, se njohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia është kusht për anëtarësimin e Serbisë në BE – është inkurajues në përpjekjet tona që rezultati përfundimtar të jetë një marrëveshje e detyrueshme ligjore, që përcakton qartësisht njohjen e ndërsjellë, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtimin e drejtë të minoriteteve konform Kushtetutës së Kosovës”, ka thënë presidenti Begaj në Prishtinë.

Ai i është referuar formulës së rezultatit të dialogut Serbi - Kosovë, të përcaktuar nga presidenti amerikan Biden, si “një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve, të fokusuar në njohjen reciproke”. “Dialogu me Serbinë është e vetmja mënyrë që të bëhet e qartë se realiteti i Kosovës së pavarur është i pakthyeshëm dhe i pandryshueshëm”, ka thënë Begaj gjatë vizitës zyrtare në Kosovë.

Grenelli: Marrëveshja e Uashingtonit u negociua e gjitha nga Thaçi

UASHINGTON, 17 GUSHT (ER) - Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka thënë se ish-presidenti Hashim Thaçi e kishte negociuar me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, marrëveshjen e Uashingtonit, dhe jo kryeministri i atëhershëm, Avdullah Hoti, i

cili e kishte nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë më 4 shtator 2020. “Marrëveshja e gjitha ishte negociuar nga Thaçi. Hoti nuk kishte negociuar pjesën më të madhe të saj”, ka thënë ai në një intervistë për “The Pavlovic Today”.

Grenelli e ka quajtur radikal kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, duke thënë se ai kishte

refuzuar njohjen e ndërsjellë të targave. “Tash e kemi këtë djalin radikal, Kurtin. Sipas një burimi të besueshëm, në dhomë, gjatë bisedimeve për targa, Kurti në mënyrë të njëanshme refuzoi njohjen e ndërsjellë të targave. Është e frikshme se njerëzit nuk e ndajnë Kosovën nga Kurti”, ka thënë ai.



A i është rikthyer ambasadorit Hill dëshira për Kosovën me autonomi substanciale?



Shkruan: Behxhet
Sh. SHALA - BAJGORA

Deri ku shkon kompromisi:

Kosova është para një sfide të madhe. Edhe kjo pavarësi, pa sovranitet të plotë mbi një integritet territorial të munguar, po rrezikohet si nga injoranca, mediokriteti dhe pafuqia e politikanëve kosovarë, po ashtu edhe nga agresiviteti, dhuna dhe brutaliteti i politikës serbe, e cila, çuditërisht, po heshtet nga politika ndërkombëtare dhe qendrat e vendosjes. Jemi dëshmitarë se një kohë të gjatë po dhunohemi nga ndërmjetësuesit dhe “lehtësuesit” ndërkombëtarë si soji dhe lloji i bareshës Ashton, dona Federika Mogerinit dhe, së fundi e më së shumti, nga dy mashtrues ordinerë dhe mohues institucionalë dhe shtetërorë të pavarësisë së Kosovës, Borrellit dhe Lajçakut, njëri nga Shumadia e tjetri nga Beogradi sa i përket përcaktimit politik. Çështjen e Kosovës e kanë tjerë hollë e hollë sipas parimit, tjerre dhe të mos e këputet, në mënyrë që kjo të zgjasë sa më shumë dhe sa më gjatë. Çështjen e Kosovës po e përdorin për sistemimin dhe promovimin e politikave, hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve të dështuar dhe të korruptuar ndërkombëtar, që nga koha e paraluftës, luftës, Tribunalit të Hagës, gjykatave të UNMIK-ut dhe të EULESH-it e deri te monstumi i sotëm juridik, Gjykata Raciste Speciale e Mongolisë, e maskuar si gjykatë e Kosovës.

Serbia ka ndërtuar një mekanizëm paralel shtetëror në Kosovë me ndihmën e kriminelëve të luftës dhe të paqes me të cilin ka ndërtuar një shtet brenda shteti dhe të cilin e vë në veprim çdoherë kur i duhet për arritjen e qëllimeve politike. Sikur që tani po vepron duke i rikthyer barrikatadat në veri të Kosovës dhe duke dhunuar Policinë e Kosovës në kryerjen e detyrimeve ligjore. Ndërkombëtarët, në përpjekje, kinse për të na ndihmuar

thuaja janë shndërruar në pjesë të strukturave paralele; thonë se mund ta integrojmë veriu por vetëm në mënyrë paqësore ndonëse vet u detyruan ta bombardojnë Serbinë shkaku se nuk u përfillë alternativa paqësore. Për ta bërë më të lehtë sundimin dhe shndërrimin e destabilizimit në mënyrë të sjelljes, veprimit dhe jetesës, aq thellë e kanë përçarë hapësirën politike kosovare, madje edhe shqiptare sa që, në jo pak raste më shumë zhvillohet luftë midis subjekteve politike kosovare dhe shqiptare se që kundërshtohet Serbia dhe strukturat paralele. Interesant që në të gjitha ekipet negociatore, spiritus movens e vendimeve ka qenë ndikimi i pasardhësve biologjikë dhe politikë i ish-bashkëpunëtorëve të Jugosllavisë dhe të Serbisë, dhunues të çdo përpjekjeje për çlirim, liri dhe bashkim kombëtar apo edhe shtet të mëvetësishtëm. Këta ishin pjesë e të gjitha qeverive kurse në qeverinë Kurti 2 janë shpirti dhe truri që kanë metastazuar në të gjitha segmenetet institucionale të Kosovës.

Albin Kurti, kryeministër i Kosovës, me më shumë se 50 për qind të votave, po përballet me probleme të shumta, në dukje të papërballueshme, qoftë për shkak të problemeve të trashëguara, megalomanisë që e përcjell në çdo paraqitje dhe veprim, politikës kriminele të Serbisë dhe oportunitetit dhe politikës anuese të vendimmarrësve ndërkombëtarë sikur edhe krizës globale që po e bënë jetën e pajetueshme në Kosovë dhe thuaja në tërë botën. Përkundër të gjitha këtyre problemeve, më shumë të natyrës objektive, kryeministri Kurti po sillet si Valentino Corleone duke luajtur lojën e “ruletës ruse” me qytetarët e Kosovës. Në vend se të jetë shumë dashamirës me opozitën, kjo që është në vend se të veprojë në planin ekonomik për të lehtësuar, qoftë edhe vetëm pak gjendjen e qytetarëve të Kosovës ndaj të cilëve po e vazhdon politikën e qeverive të mëparshme të diskriminimit në baza etnike dhe politike, e ka bërë kabinetin qeveritar me eunukë intelektualë, profesionalë dhe politikë për ta ruajtur haremën të cilin e quan qeveri të Kosovës. Në kohë krize, pasiguria

ekonomike dhe politike përpjesëtohet për të gjithë kurse megalomania duhet të dërgohet atje ku edhe mund të trajtohet profesionalisht, në Klinikën Psikiatrike dhe jo të serviret si model i suksesshëm i qeverisjes. Deri në një masë klientelizmi politik mund të durohet, sidomos në shtetet e Ballkanit Perëndimor është e palejueshme që klientelizmi politik të përdoret si mjet për ardhje në pushtet kurse, kur ta zbatoni në masë shumë më të madhe se të tjerët këtë e heshtni apo e arsyetoni sikur që është gjëja më e mirë për vendin dhe qytetarët e saj.

Albin Kurti është përballë një presioni të madh ndërkombëtar dhe është vendosur midis darëve që fuqishëm po e ngufatin; midis Serbisë dhe presioneve ndërkombëtare. Opozita e Kosovës është krejtësisht jashtë loje në këtë linçim të Albinit që po i bëhet përmes presioneve. Si njohës i mirë i Revolucionit Borgjez Francez, Albin Kurti e ka të qartë fatin e Dantonit, Robespjerit, Monteskjës dhe udhëheqësve tjerë të cilët për pushtet i dërgonin kundërshtarët në gjyotinë për të përfunduar edhe vet në gjyotinë. Nuk mund të ndjehet as i lumtur, as i përmbushur e as i sigurt kryeministri Kurti dhe disa ministra paranojakë të kabinetit qeveritarë shkaku se ish-bartësit më të lartë të institucioneve të Kosovës, krijues të lirisë dhe të paqes janë aktualisht nën gjyotinën e Gjykatës Raciste në Hagë, sipas xhelatit Dik Marti shkaku se Albin Kurti domosdoshmërisht do të përfundojë nën gjyotinën e burokratëve të Evropës dhe të ndonjë ambasadori të shpenzuar dhe të ricikluar enkas për Kosovën, nëse nuk luan lojën e ndyrë të tyre, deri në fund dhe përtej fundit! Për mendimin tim, kryeministri Kurti, i rrethuar dhe shoqëruar me injorantë, mediokër dhe antikombëtar nuk mund të ketë fat më të mirë përveç gjyotinimit. Në rastin më të mirë mund të shpëtojë vetëm nëse tërhiqet nga procesi ku kërkohen kompromise dhe lëshime të dhimbshme të cilat nuk kanë të përfunduar dhe nuk dihet as intensiteti e as vëllimi i këtyre vuajtjeve të dhimbshme. Albin Kurti, nëse do ta ketë një strategji dalëse të dinjitetshme, duhet ta ndërtojë

një konsensus politik dhe kombëtar duke lënë anash, mbase edhe përkohësisht megalomaninë dhe duke u liruar nga injorantët dhe antikombëtarët që i ka në qeveri, me tepricë përmes riformatizimit të qeverisë. Duhet ta harrojë hakmarrjen ndaj kundërshtarëve politikë, ndaj atyre që e kanë përkrahur në kohët më të vështira dhe të cilët edhe sot e përkrahin, pa asnjë dyshim dhe shumë më sinjertë se kjo “Çeta e Profetëve Injorantë dhe Antikombëtarë”. Asociacioni si e propozon Serbia e që po e përkrahin edhe lehtësuesit dhunues ndërkombëtarë është vetëm njëra nga hallkat që pashmangshëm, në të ardhmen, Kosovën do ta shndërrojë në peng të Serbisë dhe do ta bëjë të varur nga Serbia. Për këtë arsye edhe bëhet aq presion tek Albin Kurti, pikërisht për asociacionin apo “Zajednicën”, shprehje dhe armë e IV-së. Së fundi, këmbëngulës dhe partizan i asociacionit dhe kompromiseve të dhimbshme po paraqitet “buldozeri” i diplomacisë amerikane, ambasadori i ShBA-së në Beograd, Kridtofer Hill, luftëtar i pakompromis për autonominë substanciale të Kosovës në prag dhe gjatë luftës në Kosovë. Për këtë arsye i pati thyer shtizat me bacën Adem Demaçi që nuk pranonte asnjë lloj autonomie, dhe pikërisht për këtë, me dëshirë nuk takohej me Hillin. Tash, faktori politik kosovar me dëshirë dhe vullnet të plotë e ka përkrahur Hillin si njeri që do ta detyrojë Kosovën të përkrahë pavarësinë e Kosovës e po del se duhet të detyrohet të pranojë kompromise të dhimbshme që duhet të bëjnë të dyja palët (barazon Serbinë kriminale me Kosovën e dhunuar nga Serbia, si në kohë lufte ashtu edhe në kohë të paqes deri më sot) që nuk është as zgjidhje e drejtë e as e qëndrueshme. Kristofer Hill sidomos insiston për asociacionin sikur të bëhej fjalë për zgjidhje të dy shteteve që kanë marrëdhënie, nëse jo miqësore së paku të konsoliduara e jo midis një shteti skajshmërisht armiqësor ndaj një shteti që vazhdimisht përballet me shantazh dhe detyrime të vendosura nga bashkësia ndërkombëtare. Unë aspak nuk i besoj “qëllimit të mirë” të Kristofer Hillit dhe i

kam frikë dinakërisë politike dhe diplomatike që e ka praktikuar që nga ditët e para në Kosovë. Asociacioni i propozuar dhe përkrahur nga Serbia dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare paraqet “Njën e Gordit” duke krijuar një lidhje të pashkëputshme dhe të kushtëzuar midis Kosovës dhe Serbisë. Para dhe gjatë Konferencës së Dejtonit ishin dhënë zotime se Bosnja nuk do të ndahej dhe se do të ishte në dhe e pandashme. Shihni ku është sot Bosnja, as nuk është një, as nuk është funksionale dhe nuk është aspak e pandashme! Kosova, në këtë kontekst është shumë e ngjashme dhe lehtësisht mund të bëhet më keq se Bosnja. Bosnja ka homogjentitet territorial etnikisht të pastër, Kosova është e leopardizuar territorialisht pikërisht në baza etnike. Albin Kurti duhet të zbrës nga retë e pushtetit, të mos mbahet për degë dhe gjethe, por të mbahet fort për trunq duke iu kthyer rrënjëve kombëtare dhe politike, ndryshe e pret fati i Dantonit sepse retorika për aq sa të lehtëson marrjen e pushtetit, ta shkurton dhe lehtëson rrugën drejt gjyotinës, në rastin konkret asaj politike. Takimi nesër në Bruksel është vazhdim i përrallave të mëparshme të të gjitha qeverive të cilat ishin mbuluar me kostume të kushtueshme. Kurse, vet procesi e vë kryeministrin Kurti në pozitë ose të ndahet i mbuluar me do zhele politike e që do të ishte shumë më e ndershme ose të mbesë i lakuriqësuar sikur mbreti në përrallat e Andersonit. Unë në asnjë mënyrë nuk ia dëshiroj këtë të fundit!

Jetësimi i parashikimeve të Ben

Nostradamusit: Beni i LDK-së paralajmëroi se disa deputetë do t'i bashkëngjiten LDK-së. Dallëndyshja e parë e këtij shtegtimi politik ishte largimi i Doarsa Kica-Xhelilit (mbiemër shumë i afërt me LDK-në) nga lista s'Guxo! Personalisht nuk jam brengosur aspak sepse sa të jenë në këtë listë Katran Shavri dhe Haxhiqamili, Lista ka perspektivën... e Mefistofelit. Në çastin e fundit Doarsa ka shpëtuar, politikisht dhe njerëzisht, më së shumti shpirtërisht. Ka kaluar koha e “Shpitrave të shitur”, besoj fuqishëm!

Opozita kërkon shkarkimin e ambasadorit Martin Berishaj

Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka ushtruar kallëzim penal kundër ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj. Berishaj dyshohet për mosdeklarim dhe fshehje të pasurisë, pasi në formularin e deklarimit të pasurisë më 2021 nuk i ka deklaruar aksionet e tij në kompaninë private "MB Consulting". Pas këtij kallëzimi penal, PDK-ja dhe LDK-ja kanë kërkuar shkarkimin e Berishajt nga pozita e ambasadorit në Zagreb



kryeministri Kurti dhe presidentja Osmani", ka thënë Abdullahu. Edhe kryetarja e Forumit të Gruas në LDK-së, Jehona Lushaku-Sadriu, ka kërkuar shkarkimin e ambasadorit Berishaj. Ajo ka thënë se përfshirja e zyrtarëve të shtetit në afëra korruptive dëmton imazhin e Kosovës. "Agjencia Kundër Korrupsionit sot ka dorëzuar përfundimisht kallëzim penal ndaj ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, mbi faktet shokuese të bëra publike muaj me parë. Kallëzimi penal është përfundim logjik ndaj një skandali të fshehjes së të hyrave prej gjysmë milioni. Hapja e hetimeve, por edhe përfshirja e një ambasadori të Kosovës në skandale ndërkombëtare financiare, dëmtojnë rëndë imazhin e vendit tonë, rrjedhimisht e bëjnë të pamundur përfaqësimin e shtetit. Prandaj, deri në përfundimin e rastit në fjalë kërkojmë shkarkimin e ambasadorit Martin Berishaj siç dhe kërkojmë sqarimin e secilit zyrtar publik, që në filllet e shpërthimit të këtij skandali, kishin garantuar dhe marrë në mbrojtje ambasadorin në fjalë", ka shkruar Lushaku-Sadriu në "Facebook".

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë kërkuar shkarkimin e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, pas kallëzimit penal kundër tij nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK). Zëdhënësi i PDK-së, Faton Abdullahu, në një konferencë për medie ka thënë se kjo parti në vazhdimësi ka insistuar të ndriçohet rasti i ambasadorit Berishaj. "I tillë çfarë ishte si rast, ka hapur shumë pyetje dhe dilema, ndërkaq për këtë rast nga ana e pushtetarëve ka pasur pak e hiç përgjigje dhe ato ishin të çuditshme dhe të paargumentuara, e për rrjedhojë

krejt kjo ka ngjallur me të drejtë dhe pandalshëm shumë dyshime. Për ne si Parti Demokratike ka qenë skandaloze se, edhe përkundër fakteve që janë sjellë më herët për këtë rast, ambasadori Martin Berishaj është mbrojtur nga pushtetarët aktualë, madje edhe nga kryeministri dhe nga presidentja", ka thënë ai. Abdullahu ka thënë se mbrojtja e ambasadorit Berishaj me kaq konsekuencë dhe për një periudhë kaq të gjatë nga kryeministri Albin Kurti dhe presidentja Vjosa Osmani vazhdon të jetë enigmatike. Sipas tij, një veprim i tillë ishte ndërhyrje e pastër në sistemin e drejtësisë. "Ne duam të besojmë shumë dhe kërkojmë me ngulm që të jepen përgjigjet e faktuara mbi atë se ku mbetën 600 mijë eurot e këtij

personi i cili ka qenë edhe anëtar i LV-së dhe promotor i kësaj partie në Slloveni dhe gjithandej Evropës, në veçanti të Kurtit politikan, të cilin me anketa të shpifura nga Sllovenia, nga viti 2013 e këndeje proklamohet si fitues i zgjedhjeve. Firma e tij ka vetëm një të punësuar, konkretisht vetëm Martin Berishajn. Si është i mundur ky qarkullim me vetëm një njeri?! Pse ai nuk e ka deklaruar kompaninë e tij të cilën e ka në Mal të Zi, pse edhe dy kompani të tjera me seli në Kosovë ('Myloja LLC' dhe 'Zaslon Kosova LLC') nuk i ka deklaruar në formular", ka thënë Abdullahu. Më tutje, ai ka thënë se për PDK-në kjo qasje e pushtetarëve sot është mentaliteti populist i pushtetit që bën paqe të

kamuflluar me korrupsionin, në anën tjetër trumbeton shurdhueshëm për luftë kundër tij. "Marrë parasysh të gjitha këto dhe të tjerat si këto, ne si Parti Demokratike e Kosovës kërkojmë që ambasadori Berishaj të shkarkohet urgjentisht, pos të tjerash, edhe me qëllim që të mundësohet hetim i drejtë dhe i papenguar. Kjo është dashur të bëhet edhe më herët, por këtë nuk e ka bërë pushteti që e ka mbrojtur dhe përkrahur. Kemi të drejtë të dyshojmë se do të ketë interferim të pushtetit populist në institucionin e pavarur siç është Prokuroria e Shtetit. Kërkojmë nga pushteti t'i mbajë duart larg nga hetimet, sidomos tash kur kemi parasysh zellin populist që është treguar në mbrojtjen e ambasadorit Berishaj nga

Procedohet për konsultime Projektligji i Pagave dhe ai për zyrtarët publikë

PRISHTINË, 17 GUSHT (ER) - Projektligji për Pagat dhe ai për zyrtarët publikë është proceduar për konsultime. Lajmin e ka bërë me dije ministri i Punëve të Brendshme dhe i Administratës Publike, Xhelal Sveçla. "Ju bëjmë me dije se sot, pas një pune dinamike, për shumë muaj kemi proceduar në konsultime paraprake dy projektligje: Projektligjin për Pagat në sektorin publik dhe Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Projektligji për Pagat ka për qëllim kryesor përcaktimin dhe rregullimin e sistemit të pagave dhe shpërblimeve për të gjithë të



punësuarit që përfitojnë pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Projektligji, përmes sistemit të pagave që synon të krijojë, do ta rregullojë edhe mënyrën dhe kushtet e pagesës.

Ky projektligj ngre sistemin e pagave mbi parime të afirmuara nga praktikat më të mira të kësaj fushe edhe ndërkombëtarisht. Projektligji patjetër që reflekton edhe situatën aktuale të vendit

dhe praktikën gjyqësore duke ofruar siguri juridike për parimet bazë të aplikuara", ka shkruar Sveçla në "Facebook". Ndërsa Projektligji për Zyrtarët Publikë, sipas Sveçlës, ka për qëllim kryesor rregullimin e marrëdhënies së punës të zyrtarëve e zyrtarit publik në institucionet e Republikës së Kosovës. "Projektligji do të zbatohet për zyrtarët e zyrtarin publik duke përcaktuar shprehimisht institucionet e kategoritë që nuk janë në fushëprimin e këtij ligji si dhe nënkategoritë që kanë status të veçantë, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen ndryshe. Me

qëllim të rregullimit adekuat të kornizës ligjore, projektligji do t'i adresojë problemet të cilat janë shfaqur në praktikë dhe në aspektin ligjor gjatë zbatimit të ligjit në fuqi për zyrtarët publikë si dhe do të jetë në harmoni me rekomandimet e aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese", ka shkruar ai, duke shtuar se këto projektligje do të kontribuojnë në barazi dhe drejtësi brenda sistemit të administratës. "Projektligjet do t'i kalojnë procedurat e konsultimeve paraprake dhe publike si dhe pas miratimit në qeveri e Kuvend do të publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", ka shkruar Sveçla.

Ministri Sveçla për reciprocitetin: Të dy vendimet janë të ligjshme dhe legjitime

PRISHTINË, 17 GUSHT - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se mosvlefshmëria e dokumenteve serbe të identitetit dhe targave të automjeteve në territorin e Kosovës është e ligjshme dhe legjitime. Sveçla, në një intervistë për "Associated Press", ka thënë se të dy vendimet vijnë pas një procesi të gjatë negociatash. "Janë dy vendime, vendime legjitime të Qeverisë së Kosovës, lidhur me formën hyrëse-dalëse për qytetarët e Serbisë dhe transformimin e

targave të veturave nga të paligjshme në legale. Të dyja këto vendime janë të ligjshme, legjitime dhe vijnë pas një procesi të gjatë negociatash. Padyshim të dështuara, ndërsa Kosova bëri gjithçka që mundi për të arritur një lloj marrëveshjeje rreth procesit", ka thënë Sveçla. Më tutje, ai ka thënë se institucionet e sigurisë së Kosovës janë të obliguara për ta siguruar jetën e qytetarëve dhe se të njëjtat institucione janë të afta dhe të trajnuara për ta bërë këtë në mënyrën më të mirë. "Sigurisht, institucionet e

sigurisë së Kosovës janë të obliguara që t'i ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta siguruar lirinë e lëvizjes, për ta siguruar jetën e qytetarëve të Kosovës, për ta siguruar infrastrukturën kritike, por edhe për t'i siguruar institucionet tona private dhe publike, ndërtesat nga cilido shkatërrim dhe apo ndonjë rrezik. Por, ne jemi të bindur se institucionet e Kosovës janë të afta dhe të trajnuara për ta bërë këtë në mënyrën më të mirë të mundshme, pa shënjestruar apo pa ndonjë lëvizje diskriminuese ndaj askujt", ka



thënë Sveçla, duke e akuzuar Serbinë dhe aleatën e saj, Rusinë, për shkaktimin dhe mbështetjen e trazirave. "Nuk ka rezistencë serioze nga qytetarët. Siç e thashë, kjo

është e fryrë dhe e importuar nga Serbia dhe Rusia, pasi janë më të mëdhenj të ashtuquajtur 'vëllai më i madh', për ta nxitur dhunën në Kosovë", ka thënë Sveçla.

Sa importon nga Serbia dhe sa eksporton Kosova mallra në Serbi?

PRISHTINË, 17 GUSHT - Serbia eksporton në Kosovë mallra me vlerë prej qindra miliona eurosh çdo vit. Por, në Serbi, interesimi për produkte nga Kosova është dukshëm më i vogël.

Kosova blen pije joalkoolike, produkte gruri, vajra, yndyra

dhe produkte ushqimore nga Serbia, së cilës i shet gypa e tuba, fruta dhe artikuj plastike. Në vitin 2020 Kosova ka eksportuar 31 milionë euro në Serbi, kurse ka importuar 174 milionë euro mallra.

Në vitin 2021 importi nga Serbia është gati dyfish më i

madh në krahasim me një vit më herët, raporton "Rel".

Gjatë vitit që lamë pas Kosova ka importuar 306 milionë euro mallra nga Serbia, kurse ka eksportuar 44 milionë euro mallra në shtetin fqinj.

Gjatë vitit 2019, kur Qeveria e Kosovës vendosi taksë prej

100-përqindësh ndaj produkteve serbe, importi nga Serbia ishte 6 milionë euro, kurse eksporti në Serbi 27 milionë euro.

Importi më i lartë i mallrave serbe ishte në vitin 2017, me 450 milionë euro mallra të importuara.



Shatri për situatën ekonomike: Qeveria Kurti po vepron sikur të ishte armike e qytetarëve

PRISHTINË, 17 GUSHT - Ish-ministri i Financave, Haki Shatri, ka vlerësuar se mosinvestimet në energji do të sjellin pasoja të rënda për ekonominë vendëse. Në këtë kontekst, Shatri ka shprehur kritika në drejtim të qeverisë Kurti për mënyrën sesi i është qasur krizës energjetike, për të cilën ka thënë se do të ketë impakt negativ në ekonomi.

Duke folur për mungesën e energjisë, Shatri ka thënë se e njëjta sjell pengesa në zhvillim si dhe rrit papunësinë dhe varfërinë. "Energjia, përveç që është faktor kyç në standardin jetësor në aspektin e përgjithshëm, energjia edhe është një prej tre faktorëve kyçë në prodhimtari, që i bie në zhvillim ekonomik. Energjia, lënda e parë

dhe fuqia punëtore, janë tre faktorë të zhvillimit ekonomik. Mungesa sjell pengesa në zhvillim, dështim në realizimin e zhvillimit ekonomik. Dështimi në zhvillim e rrit varfërinë, e rrit papunësinë, e varfëron popullsinë dhe e kthen në pjesë të popullsisë që konsiderohet e mesme, i lëshon një gradë më poshtë sa i përket gjendjes ekonomike", ka thënë Shatri.

Kritika ka pasur edhe për shumën e mjeteve që vazhdojnë të qëndrojnë në llogarinë bankare të qeverisë. Ai ka thënë se mosqarkullimi i atyre mjeteve është dështim.

Më tutje, Shatri e ka akuzuar qeverinë Kurti për mënyrën sesi është duke qeverisur, për të cilën ka thënë se ngjason sikur "Kosova



të qeveriset nga armiku". "Stoku i mjeteve monetare të domosdoshme të qëndrojnë si rezervë është i përcaktuar me ligj

për buxhetin dhe ai duhet të respektohet sepse e garanton stabilitetin buxhetor, por në raportin e gjashtëmuorit të

ecurive buxhetore shohim që në stokun e mjeteve që ruhen në BQK, këto mjete janë dyfishuar. Mosfutja e parave në funksion nuk është ndonjë ekonomizim i mençur, por është dështim. Pjesët e tjera të parave publike që janë të parapara për investime kapitale duhet menjëherë të hyjnë në funksion. Është shqetësuese që kjo qeveri në pjesën e investimeve kapitale është duke dështuar. Është sikur ta ketë armiku qeverinë në dorë e jo njerëzit tanë të zgjedhur me votë. 200 milionë kanë dështuar vitin e kaluar në kategorinë e investimeve kapitale. Këtë vit është thelluar si problem. Sipas raportit, vetëm 11 për qind e shumës vjetore të paraparë për investime kapitale është realizuar deri më tani", ka thënë Shatri.

Shtatë persona humbën jetën në vendin e punës gjatë këtij viti në Kosovë

PRISHTINË, 17 GUSHT - Siguria në punë vazhdon të jetë problem për punëtorët në Kosovë. Si rezultat i saj, këtë vit, deri më tani, shtatë persona kanë humbur jetën në vendin e punës dhe 173 kanë pësuar aksidente. Lajmin e ka bërë me dije për "Radio Kosovën" kryeinspektori i punës, Hekuran Nikçi. Ai ka thënë se gjatë këtij viti kanë realizuar mbi 3 100 inspektime e për shkeljet e gjetura kanë shqiptuar 175 masa ndëshkimore ndaj punëdhënësve. "Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 173 aksidente në vendin e punës, nga të cilat shtatë janë me fatalitet. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi evidentuar



104 raste të aksidentit në vendet e punës, prej tyre katër me fatalitet, që do të thotë se gjatë kësaj periudhe kemi një rritje të rasteve me fatalitet për tre", ka thënë ai.

Në rastet e aksidenteve në vendpune, kur inspektorët kanë konstatuar se është shkelur ligji nga ana e punëdhënësve, ndaj tyre janë shqiptuar masa ndëshkimore - gjoja me para. Sipas ligjit, këto gjoja mund të jenë deri në 40 mijë euro, kurse Nikçi ka treguar për numrin e kontrolleve që ka bërë Inspektorati i Punës gjatë këtij viti. "Gjatë kësaj periudhe kohore Inspektorati i Punës ka realizuar 3 mijë e 178 inspektime. Gjatë inspektimeve

është konstatuar se numri më i madh i shkeljeve të drejtave të të punësuarve është në sektorin e ndërtimit, që kanë të bëjnë me kushtet e punës, pastaj prodhimtaria dhe gastronomia, ku është konstatuar se ka punëtorë pa kontrata apo që nuk janë të deklaruar në ATK", ka thënë ai.

Më tutje, Nikçi ka treguar se, pas kontrolleve të bëra, deri tani ndaj punëdhënësve të cilët kanë cenuar legjislacionin që mbikëqyr Inspektorati i Punës kanë shqiptuar 175 masa ndëshkimore, të cilat ka thënë se dallojnë varësisht nga shkeljet ligjore që janë konstatuar nga inspektorët në terren.

Mbi 70 milionë të rinj në mbarë botën janë ende të papunë

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka bërë me dije se numri i të rinjve të papunë në mbarë botën do të arrijë në 73 milionë në vitin 2022, një përmirësim i lehtë nga një vit më parë, por ende shumë mbi normat e papunësisë përpara pandemisë Covid-19.

ILO-ja në raportin "Trendët botërore të punësimit për të rinjtë

2022: investimi në transformimin e të ardhmes për të rinjtë" ka theksuar se numri i grupmohës 15-24 vjeç parashikohet të bjerë me 2 milionë nga viti 2021 në 2022. Mirëpo, kjo është ende në 6 milionë të rinj më shumë të papunë në mbarë botën sesa në vitin 2019, para pandemisë. Gratë kanë gati 1.5 herë më pak gjasë se burrat për të qenë të

papunë, apo 27.4 të tyre në mbarë botën që pritet të jenë të punësuarra në vitin 2022 krahasuar me 40.3 për qind të të rinjve dhe ky hendek gjinor ishte më i madhi midis vendeve me të ardhurave të ulëta dhe të mesme dhe më i vogli në vendet me të ardhura të larta.

Përqindja e të rinjve të papunë, që i nënshtrohen arsimit ose

trajnimin në vitin 2020, viti më i fundit për të cilin disponohen të dhëna botërore, është rritur me 23 për qind, niveli më i lartë në 15 vjetët e fundit dhe është rritur me 1.5 për qind nga viti 2019 kur bota ishte goditur për herë të parë nga Covid.

Këto vështirësi në disa vende janë shtuar nga lufta në Ukrainë dhe konflikte të tjera në vendet në



zhvillim. Vendet me të ardhura të larta janë të vetmet vende që pritet të arrijnë pothuajse të njëjtat nivele të papunësisë të rinjtë si përpara pandemisë.

Jeta inteligjente në Univers mund të jetë jashtëzakonisht e rrallë. Prapëseprapë duhet ta kërkojmë



Nga Avi LOEB

Jeta inteligjente mund të jetë jashtëzakonisht e rrallë në Universin tonë, thotë profesori i Shkencave Astrofizike të Universitetit Princeton, Ed Tërner. Kjo pikëpamje nuk është befasuese, pasi jeta inteligjente është e rrallë edhe në Tokë. Ndaj shtrirja e këtij propozimi në shkallë kozmike duket e besueshme.

Në një konferencë të fundit të Projektit Galileo, Tërner u ndal tek çështja se sa të veçantë mund të jemi ne njerëzit. Unë nuk munda të rezistoj pa pyetur: “A të bëjnë fetar këto argumente?”. Ekzistojnë 2 mënyra për ta interpretuar ekzistencën tonë si qenie të ndjeshme.

Pikëpamja materialiste e konsideron vetëdijen si një fenomen me origjinë nga “supa fillestarë” e kimikateve që përshkuan Tokën në fazat e hershme të krijimit të saj. U deshën 4.5 miliardë vjet që përzgjedhja natyrore të krijonte Homo Sapiens disa milionë vjet më parë, dhe brenda 1 miliardë vjetësh nga tani Dielli do të avullojë të gjithë ujin e lëngshëm në Tokë. Thënë kështu, ekzistenca jonë në këtë planet mund të jetë përsëritur në mënyrë të vazhdueshme edhe në planetë të tjerë gjatë 13.8 miliardë viteve të fundit që nga Big

Bengu.

Mos harroni se numri i planeteve me madhësinë e Tokës në zonën e banueshme rreth një ylli të ngjashëm me Diellin, është të paktën 10 në fuqinë e 31. Ndërkohë numri i planetëve të banueshëm në hapësirë, shtrihet në një rajon 4000 herë më larg horizontit të vëzhgueshëm të Universit.

Parimi i mediokritetit (zakonshmërisë) i bën jehonë Parimit të Kopernikut. Pra që Toka nuk është në qendër të universit, dhe që ne si vëzhgues nuk jemi të privilegjuar. Inteligjenca u shfaq në 1/5 e fundit të jetës së Tokës si një planet i banueshëm. Por kjo gjë nuk na bën domosdoshmërisht të rrallë, duke pasur parasysh se shumica e yjeve u formuan miliarda vjet përpara Diellit.

Ashtu si me kompozitorin Wolfgang Amadeus Mozart, i cili vdiq para kohe, pak para se të mbushte 36 vjeç, qytetërimet më të përparuara jashtëtokësore mund të kenë vdekur në kohën kur ne arritëm jetëgjatësinë e tyre teknologjike dhe po përpiqemi të riprodhojmë arritjet e tyre mahnitëse.

Kërkimi i sinjaleve të tyre të radios, duke i bërë jehonë hapave tanë teknologjikë foshnjorë, do të ngjante me një përpjekje joreale për të kontaktuar Mozartin përmes telefonit pas vdekjes së tij. Në

vend të kësaj, ne duhet të kërkojmë reliket që lanë pas këto qytetërimet, ashtu si notat muzikore të Mozartit.

Në anën tjetër të argumentit, “hipoteza e Tokës së rrallë”, rendit shumë ngjarje dhe rrethana astrofizike të pamundura që nevojiteshin për ekzistencën e jetës tokësore. Kjo hipotezë na bën të ndihemi të veçantë. Por ajo nxit tek ne gjithashtu edhe një ndjenjë përgjegjësie.

Nëse jemi të rrallë në kozmos, atëherë duhet të garantojmë mbijetesën tonë afatgjatë. Për këtë qëllim, ne mund të dëshirojmë të përhapim kopje të ekzistencës sonë të çmuar diku tjetër në sistemin diellor ose në galaktikën e Rrugës së Qumështit, në mënyrë që ekzistenca jonë të mos jetë e prekshme ndaj një ngjarje katastrofike për planetin tonë.

E çfarë rëndësie ka nëse jemi të zakonshëm apo të veçantë? Është një kërkim shkencor në lidhje me reliket e qytetërimeve teknologjike jashtëtokësore. Siç e di cilido ekspert në këtë fushë, gjetja e diçkaje të tillë kërkon përpjekje dhe burime të mëdha e të vazhdueshme. Duke besuar se jemi unikë, kjo na de-motivon për t'i vazhduar kërkimet. Por pa kërkuar, nuk do ta dimë kurrë nëse jemi vërtet unikë në Univers. Provat shkencore nuk janë të detyruara të përputhen me keqkuptimet tona,

sidomos nëse ato janë të nxitura nga një ndjenjë privilegji e pabazuar.

Kërkimi shkencor, buron nga gatishmëria jonë për të pranuar prova, të cilat rrëzojnë bindjet tona të mëparshme. Është detyrimi ynë ndaj titullit “qytetërim inteligjent” që i kemi caktuar vetes, ai që na bën t'i përshtatemi vëzhgimeve agnostike të realitetit, në vend se t'i dorëzohemi një ndjenje të ekzagjeruar të rëndësisë së vetvetes.

Qasja tradicionale e “Kërkimi për Inteligjencën Jashtëtokësore” (SETI) me kërkimin e sinjaleve radio, plotësohet tani nga Projekt Galileo në Universitetin e Harvardit, të cilin e drejtoj unë, programi i parë kërkimor shkencor i financuar privatisht në kërkim të objekteve pranë Tokës, që mund të kenë origjinën nga një qytetërim jashtëtokësor.

Gjetja qoftë edhe e një objekti të vetëm jashtëtokësor, do të mjaftonte për të zgjidhur debatin rreth statusit tonë intelektual në kozmos. Gjetja e një objekti të tillë pas një kërkimi shterues, do të vendoste kufizime në aftësitë teknologjike apo motivimet e kujtdo tjetër atje tej.


Kërkimi për të panjohurën rezonon me spiritualitetin dhe jo vetëm materializmin, sepse ne kurrë nuk e dimë se çfarë

mund të gjejmë. Aktualisht, nuk ka asnjë plan që të lidhet me kërkimin e qytetërimeve të tjera. Por mund të imagjinojmë fitime të mëdha nga importimi i teknologjive të panjohura në Tokë.

Edhe kultura jonë mund të përfitojë shumë nga njohuritë e reja shkencore. Por ashtu si mundësitë e kontakteve aliene, ne duhet së pari të investojmë përpjekje dhe burime të mëdha në kërkime. Në konferencë, Tërner paralajmëroi se Projekt Galileo mund të mos gjejë asgjë.

Sipas mendimit tim, duke kërkuar të paktën do të jemi të vetëdijshëm se jemi përpjekur. Çfarëdo që të gjejmë, të mësuarit nga përvoja na ofron një ndjenjë qëllimi apo kuptimi për jetën tonë. Ne kemi nevojë për një grup të ndryshëm skeptikësh dhe avokatësh në kërkimin e qytetërimeve të mundshme jashtëtokësore, në mënyrë që kur të gjithë të bien dakord, provat e mbledhura të kenë një interpretim të fortë. Kjo është marka tregtare e metodës shkencore.

Shënim: Avi Loeb, është kreu i Projektit Galileo dhe drejtor i Institutit për Teori dhe Llogaritje në Qendrën e Astrofizikës Harvard-Smithsonian. / “The Hill” – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Në Mitrovicë do të zhvillohen kualifikueset e FIBA Europe Cup

MITROVICË, 17 GUSHT - Të mërkurën janë shpallur nikoqirët e katër turneve kualifikuese, që do t'i ndajnë biletat e fundit të mbetura për edicionin 2022-2023 në FIBA Europe Cup. Nënkampionia e Kosovës, Trepça, do të jetë organizatore e turneut A. Mitrovicasit do të përballen me BG Gottingenin e Gjermanisë në çerekfinale, kurse në gjysmëfinale i pret Sporting CP e Portugalisë. Thor Thorlakshofn i Islandës do të ndeshet me Petrolina AEK në ndeshjen tjetër çerekfinale, me fituesin që do të përballen me pas me Telenet Giants Antwerp të Belgjikës. Ndeshjet çerekfinale do të zhvillohen më 27 shtator, gjysmëfinale më 28 shtator dhe finale më 30 shtator. Kjo është hera e

parë që mitrovicasit garojnë në FIBA Europe Cup dhe organizojnë një ngjarje të tillë. Turneu B do të zhvillohet në Lituani, ku Cbet Jonava do të jetë mikpritëse dhe do të përballen me SCMU Craiova të Rumanisë në përballjen e parë çerekfinale. Fituesi do të përballen me Kapfenberg Bulls

në gjysmëfinale, ndërsa në gjysmëfinalen tjetër Sigal Prishtina e pret fituesin e përballjes çerekfinale mes KK Cedevita Junior të Kroacisë dhe Kalev/Cramo të Estonisë. Rilski Sportist i Bullgarisë do ta presë Turneun C, ndërkohë klubi francez Cholet Basket do ta organizojë Turneun D.

Turnetë kualifikuese

Turneu A: KB Trepça në: Mitrovicë, Kosovë
Turneu B: Cbet Jonava në: Jonava, Lituani
Turneu C: Rilski Sportist në: Samokov, Bullgari
Turneu D: Cholet Basket në: Cholet, Francë

Ditët e ndeshjeve:

27 shtator - çerekfinale
28 shtator - gjysmëfinale
30 shtator 2022 - finale



KOK-u fiton projekt në 'Erasmus Plus'



PRISHTINË, 17 GUSHT - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) për herë të parë ka fituar projekt në Unionin Evropian përmes programeve të "Erasmus Plus", i cili do ta shtojë buxhetin e KOK-ut për vitin 2022. Projekti i fituar është "Ngritja e kapaciteteve në fushën e sportit", udhëheqës i të cilit është Organizata Sportive JoQeveritare e Evropës (ENGSO). Krahas KOK-ut, pjesë e projektit të fituar janë edhe tri komitete olimpike

kombëtare: Komiteti Olimpik Kombëtar i Shqipërisë, Komiteti Olimpik i Malit të Zi dhe Komiteti Olimpik i Bosnjë-Hercegovinës. Po ashtu, partnerë të tjerë të projektit janë edhe Universiteti i Prishtinës, Organizata për Edukim në Sport e Italisë dhe Konfederata e Sportit të Portugalisë. Me fitimin e këtij projekti KOK do të organizojë aktivitete në partneritet me organizatat e lartpërmendura, ndërsa e veçanta është se

aktiviteti madhor dhe përmblyës i projektit do të mbahet në Kosovë. Aktivitetet kanë të bëjnë promovimin e vlerave pozitive përmes sportit në relacion me integritetin, sigurinë në sport, "fair-play", tolerancën, shpirtin ekipor dhe barazinë në sport, të cilat do të organizohen përmes trajnimeve me sportistë nëpër komuna, shkolla, përfshirjen e fëmijëve etj. KOK-u është anëtar i ENGSO nga qershori i vitit 2017.

Reagon Besa: Nuk do të shuhemi

PEJË, 17 GUSHT - Skuadra e Besës së Pejës, me anë të një njoftimi në faqen zyrtare, ka konfirmuar se nuk do të shuhet dhe se do të marrë pjesë në garat e futbollit të Kosovës për sezonin 2022/23. Të martën është raportuar se skuadra pejane do të shuhet pas problemeve të mëdha financiare. "Pas shumë raportimeve dhe komenteve të rrejshme nga mediet vendore, po detyrohemi të dalim me

disa sqarime. FC Besa është regjistruar pranë FFK për garat e sezonit 2022/23. FC Besa nuk do të shuhet. Besa është duke u ballafaquar me probleme financiare serioze. Kontributi i secilit dashamirës të klubit, në çfarëdo forme, është i mirëseardhur. Burimet e vetme të informacioneve zyrtare janë dhe do të mbeten kanalet zyrtare të klubit në rrjetet sociale", ka njoftuar klubi.



Kërkesa e Florian Markut: Merrini me vete flamujt kuqezi

Tiranë, 17 gusht - Florian Marku po vijon me intensitet stërvitjen për duelin e 25 gushtit në stadiumin "Air Albania". Boksieri

shqiptar do të ketë përballë një rival të fortë meksikan. Ai kërkon edhe ndihmën e publikut. "Jam gat! Edhe tetë

ditë kanë ngelur për ndeshjen më të madhe të historisë të boksit në Tiranë. Ju pres të gjithëve në stadiumin 'Air

Albania'. Merrini me vete flamujt që të krijojmë një atmosferë e cila do të mbahet mend gjatë!", ka shkruar Marku.



FC Prishtina 01 transferon lojtarin e Kombëtares së Shqipërisë

PRISHTINË, 17 GUSHT - Klubi kryeqytetas i futbollit, FC Prishtina 01, ka bërë një transferim të madh këtë verë, duke nënshkruar me lojtarin e njohur Halim Selmanaj, FC Prishtina 01

pasi ka nënshkruar me disa emra të njohur ditët e fundit, të mërkurën e ka konfirmuar edhe transferimin më të madh të verës. "FC Prishtina 01 është e lumtur t'ju njoftojë se ka arritur

marrëveshje me Halim Selmanajn. Ylli i futbollit shqiptar këtë sezon do t'i mbrojë ngjyrat bardhë kaltër. Ai gjatë gjithë karrierës ka luajtur te Liburni, ku ka fituar të gjithë trofetë e

mundshëm. Selmanaj është edhe pjesë e Kombëtares së Shqipërisë në futboll. Duke i njohur kualitetet e tij, FC Prishtina 01 është e bindur në arritjen e objektivave", ka njoftuar FC Prishtina 01.



Rrëfimi i Giggsit: Nuk mund t'i rezistoj asnjë femre tërheqëse, kam shkuar edhe me kunatën

MANCHESTER, 17 GUSHT - Ditë e re në gjyqin e Ryan Giggsit, i akuzuar nga ish-partnerja e tij, Kate Greville, për sulm dhe sjellje shtrënguese. Ish-lojtari i njohur uellsian i Manchester Unitedit bëri rrëfimin e tij të parë përpara gjykatës së kurorës së Manchesterit. Aty pranoi se "nuk mund t'i rezistoj kurrë një gruaje tërheqëse" dhe rrëfeu se kishte tradhtuar ish-gruan e tij Stacey me Kate Greville. Lidhja që nisi me këtë të fundit, siç raportoi futbollisti, kishte nisur kur të dy ishin të martuar.

Sipas fjalëve të publikuara nga gazeta "Daily Mail", Giggs ka thënë nga pozicioni i dëshmitarit se kurrë nuk u kishte qëndruar besnik të gjitha ish-të dashurave, ndaj e quajti veten "një person filtrues nga natyra".

Legjenda e futbollit ka folur për tradhtinë që ia kishte bërë ish-bashkëshortes me kunatën e tij Natasha, partneren e vëllait. Në vitin 2011 duket se Giggs i kishte ofruar vëllait të tij Rhodri 280 mijë




euro për të heshtur dhe për të mos nxjerrë më shumë informacion në lidhje me këtë. Në të njëjtin vit, "Daily Mirror" raportoi për një tradhti të supozuar të Giggsit me Lorraine Lever, nënën e kunatës së tij, Natasha. I pyetur nëse e kishte goditur ndonjëherë Kate Greville, uellsiani i Manchester Unitedit nuk kishte dyshime: "Jo". Giggs,

gjithashtu, iu përgjigj me "jo" pyetjeve nëse Kate ishte bërë "skllave e kërkesave të tij", se e kishte kërcënuar apo detyruar të kryente seks ndonjëherë një grua. Kate Greville e akuzon atë se e kishte goditur me kokë në fytyrë gjatë një debati. Lojtari e pranoi përplasjen, por tha se ishte i sigurt se nuk ishte e qëllimshme.

NBA nis më 18 tetor me një supersfidë

SAN FRANCISCO, 17 GUSHT - Mungon ende zyrtarizimi, por sezoni 2022-2023 në NBA do të nisë më 18 tetor. Lajmin e konfirmojnë mediet amerikane, që kanë publikuar edhe planin e drejtuesve të NBA-së për mbremjen hapëse. Në fushë do të zbrisë skuadra kampione e Golden States, që do të luajë në fushën e saj ndaj rivalëve të lakersave. Një super-ndeshje, ku përballë njëri-tjetrit do të jenë që në sfidën e parë LeBron Jamesi dhe Stephen Curry. Në këtë ndeshje kampionët e Warriorsit do t'i marrin edhe unazat për titullin e fituar vjet. Po më 18 tetor do të luhet edhe ndeshja mes Philadelphias e Bostonit, dy ekipe rivale dhe pretendente për titull në Konferencën e Lindjes. Pra, një start i fortë i sezonit, ku vjet e NBA-së do të zbrisin menjëherë në parket.



MË 18 TETOR TAKOHEN:
Golden State - Lakers
Philadelphia - Boston

Unitedi synon transferimin e Casemiros dhe Felixit

Manchester Unitedi nuk e ka nisur mirë sezonin e ri në Premierë Ligë. Dy humbje në dy ndeshje, starti më i keq në histori dhe vendi i fundit në

tabelën e klasifikimit, detyrojnë drejtuesit e klubit të lëvizin shpejt. "Marca" raporton se Unitedi po kërkon të bëjnë "pazar" në Madrid,

ku kërkojnë yjet e Realit dhe Athleticos. Casemiro është objektivi kryesor për ta përforcuar mesfushën në një kohë kur pista Rabiot ka rënë

përfundimisht. Objektivi tjetër, për ta përforcuar repartin ofensivë, është Joao Felix. Pavarësisht prej dëshirës së Unitedit, gjithnjë

sipas së përditshmes spanjolle, si Real ashtu edhe Atletico nuk kanë ndër mend të privohen nga dy titullarët e tyre.

SHKURT

Hamiltoni: Kur Alonso të tërhiqet, unë do të jem ende në pistë

Nga botërori i Formulës 1 do të largohet në fund të këtij sezoni një ikonë e këtij sporti, Sebastian Vettel, katër herë kampion bote. Ndërkohë që, në pistë janë ende dy veteranë të këtij sporti, spanjoli Fernando Alonso (2 tituj) e britaniku Lewis Hamilton (7 tituj). Alonso ka konfirmuar qëndrimin, teksa do të zërë pikërisht vendin e Vettelit tek Aston Martini, ndërsa Hamiltoni ka ende edhe një vit kontratë me Mercedesin. Gjithsesi, britaniku mendon se do të jetë në këtë sport më gjatë se spanjoli. "Kur Alonso të tërhiqet, unë do të jem ende në pistë dhe do të jem piloti më i vjetër në garë. Për sa kohë jam kompetitiv do të garoj, pasi argëtohem. Po përpiqemi ta bëjmë këtë makinë sa më të shpejtë këtë sezon", ka thënë Hamiltoni.

Më 25 gusht hedhet shorti për fazën e grupeve në Ligën e Kampionëve

UEFA ka njoftuar se hedhja e shortit për fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve do të mbahet më 25 gusht në Turqi në qytetin e Stambollit, ku do të zhvillohet edhe finalja e turneut në fund të sezonit të ardhshëm. Kujtojmë se ndeshja vendimtare e Ligës së Kampionëve në Stamboll do të mbahej në vitet 2020 dhe 2021, por në të dyja rastet ajo u zhvendos në qytete të tjera për shkak të koronavirusit. Shorti do ta përcaktojë edhe lojtarin më të mirë në Evropë në vitin 2022. Lista e aplikantëve ende nuk është shpallur. Mesfushori i Chelseat, Jorginho, i cili fitoi Ligën e Kampionëve dhe "Euro 2020", mori çmimin vitin e kaluar.

Marcelo mendon për pension

Ish-mbrojtësi i Real Madridit, Marcelo, u largua nga "galaktikët" pas përfundimit të kontratës së tij si lojtar i lirë, por ende nuk ka gjetur një skuadër edhe pse alternativat nuk kanë munguar. Sipas asaj që raporton së fundmi "Marca", braziliani me shumë gjasë do të tërhiqet nga futbollit i luajtur, si një lojtar që ka fituar gjithçka. Më parë u raportua se skuadra si Lazio apo Lyon ishin pranë një marrëveshjeje me anëtorin, mirëpo asgjë konkrete nuk ka ndodhur.

Beshiktashi interesohet për Dele Allin

Skuadra e Beshiktashit është e interesuar për mesfushorin ofensiv të Evertonit, Dele Alli. Siç raporton Fabrizio Romano, skuadra turke është duke i shqyrtuar të dyja opsionet: edhe blerjen, edhe huazimin. Prioritet për anglezin është që të ketë më shumë minuta sa ka aktualisht te skuadra nga Liverpools. Ndërkohë, Evertoni nuk e ka ndër mend të rrijë duarkryq, pasi po e monitoron nga afër situatën e Idriza Gueyes së Paris Saint Germainit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

ANADRINIA MED

SHKOLLA E MESME E LARTË E MIJËKËSISË
PRIZREN

Rr."JONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë, email: anadriniamed@gmail.com /
kbiznesi@gmail.com
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

Bazuar në nenin 15 të Statutit, të SHMLM "ANADRINIAMED" Prizren, Këshilli Drejtues shpallë:

KONKURS

Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë Anadrinia MED shpall konkurs për pranimin e nxënësve të rinj në klasën e dhjet (X-të), për vitin shkollor 2022/2023

Në drejtimin e licencuar për Arsimin e Mesëm të Lartë nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si:

- Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë

Konkursi është i hapur nga date e shpalljes deri me datën 30.08.2022.

Të drejtën e konkurrimit e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të ulët dhe të cilët e kanë përfunduar me sukses testin e arritshmërisë.

Dorëzimi i dokumenteve nga kandidatët e interesuar duhet të bëhet në mënyrë fizike në ambientet e shkollës.

Kandidatët të cilët aplikojnë duhet t'i bashkëngjitin aplikacionit:

Certifikatën e kalimit të testit të arritshmërisë për klasat e nënta (origjinale ose kopje të noterizuar);

Diplomën e shkollës së mesme të ulët (origjinale ose kopje të noterizuar);

Dëftesat e shkollës së mesme të ulët (origjinale ose kopje të noterizuar);

Certifikata e lindjes;

Dy fotografi;

Paraqitja e dokumenteve: Rr."JONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë ose përmes
e-mail: anadriniamed@gmail.com / kbiznesi@gmail.com
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Badallaj 5" Sh.p.k Vllashnje, Prizren, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për riciklimin e mbeturinave të ngurta inerte në Zhur, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.09.2022 në ora 10:00 në Adresën: Badallaj 5 Vllashnje të zyrat e firmës Badallaj 5 Vllashnje 20520, Prizren do të organizohet debat publik nga Kompania "Badallaj 5" Sh.p.k Vllashnje, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për riciklimin e mbeturinave të ngurta inerte në Zhur, Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Badallaj 5" Sh.p.k Vllashnje, Prizren për riciklimin e mbeturinave të ngurta inerte në Zhur, Prizren.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Sankovc Gllgoc shpall të pavlefshme Licencën e DDD Petrol SH.P.K. nr Unik: 811465427 me nr. Licencës 10338-00-13-14-0307.

▶ Zidi i Sahit Ages Gjakovë shpall të pavlefshme Licencën e DDD Petrol me nr Unik: 811465427, me nr Licencës 10327-00-16-07-0531.

▶ Aldi Cërmjani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

▶ Shqefqet Berisha nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. "Haxhi Hoti" Rogovë KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

▶ Nexhmije Hoti nga Ratkoci KK Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f."4 Dëshmorët" Ratkoc KK Rahovec nga kl. I-VIII.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

